

# REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Strategjitë - Sindroma e Përsëritjes:  
Pse strategjia e KLGJ-së rrezikon të  
kthehet në përsëritje të dështimit të  
planifikimit, ndërsa rritja e efektivitetit  
të gjyqësorit është sot emergjencë  
kombëtare

Av. Dr. Irena Dule



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Law Journal





---

**PUBLIKUES**

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3.

Tel: +355 44 104 247

E-mail: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org)Web: [www.em-al.org](http://www.em-al.org)**AUTORË**

Av. Dr. Irena Dule

**VITI I PUBLIKIMIT**

janar 2026

---

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



---

Hyrje	03
Pasojat e reformës mbi efikasitetin e gjyqësorit	04
Analizë kritike e Strategjisë së KLGJ 2024-2027	04
• "Katastrofa e paralajmëruar" - Gjykatës Administrative të Apelit i duhen 14.6 vite për të mbyllur një çështje	05
• Sfida Monumentale e Gjykatës së Apelit të Përgjithshëm: Loja me shifrat fsheh "Bishtin e Gjatë" të Backlog-ut	06
• Izolimi i hartimit të strategjisë nga ekspertiza e shoqërisë civile	07
• Kostoja e heshtjes pas rihartëzimit (shkurt 2023) - Një rritje e panjohur e krizës	09
• Përmirësimi i Infrastrukturës mbetet një ide e Papërcaktuar	10
• Fati i strategjisë në duart e të tjerëve	10
Përfundime	12
BIBLIOGRAFIA	14

---

Reforma në Drejtësi e miratuar në vitin 2016 ishte ndërhyrja më e thellë institucionale në sistemin gjyqësor shqiptar që prej Kushtetutës së vitit 1998. Synimi i saj ishte garantimi i pavarësisë dhe integritetit të gjyqësorit. Por, përtej objektivave, mungesa e masave tranzitore dhe mbështetëse e shndërroi reformën në një burim krize funksionale, me pasoja të rënda afatshkurtra e afatmesme për efikasitetin e gjykatave.

Boshllëqet në trupën gjyqësore u bënë të dukshme menjëherë pas nisjes së vetingut. Shqipëria u përball me mungesë të konsiderueshme gjyqtarësh e prokurorësh aktivë, gjë që solli vonesa të theksuara dhe rritje të stokut të çështjeve të prapambetura. Në vitet 2017–2020, numri i gjyqtarëve aktivë ra me mbi 30%, dhe erdhi në rënie në vitet në vazhdim. Kjo krizë e kapaciteteve nuk u shoqërua me planifikim proporcional në infrastrukturë, buxhet dhe staf mbështetës. Pasojat u reflektuan në rritjen e stokut. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) raporton se, në fund të vitit 2020, sistemi kishte mbi 110 mijë çështje në pritje.

Kjo tablo përkeqësoi perceptimin e publikut të drejtësisë. Sipas Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), mbi 70% e të intervistuarve nuk besonin se mund të merrnin drejtësi në kohë. Paralelisht, u shtuan ankesat në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për shkelje të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (gjykim brenda një afati të arsyeshëm), të pasuara me vendime pozitive, në favor të aplikantëve<sup>1</sup>.

Në këtë kontekst u artikulojnë strategji dhe

udhërrëfytes nga KLGJ. "Strategjia për uljen e numrit të çështjeve 2024-2027"<sup>2</sup> dhe "Udhërrëfytes për efikasitetin e pushtetit gjyqësor 2025–2027"<sup>3</sup>, janë dokumentet e fundit të hartuara nga KLGJ. Nevoja për këto instrumente nxjerr në pah një paradoks: Reforma, në mungesë të një arkitekture tranzicioni, krijoi vetë një krizë funksionale.

Paradoksi vazhdon, sot i materializuar edhe në strategjinë e KLGJ, e cila mbështetet në projeksione sasiore pa metodologji të plotë, nuk merr parasysh efektet e reformave si ajo e hartës së re gjyqësore që nisi në shkurt 2023, e cila sërish nuk u shoqërua me masa tranzitore. Pa i njohur dhe adresuar problemet reale rrezikohet që problemi të menaxhohet në letër, jo në sallat e gjyqit dhe sindroma e përsëritjes së paradoksit të vazhdojë.

Kjo analizë kritike shqyrton, me një lente praktike të një avokateje, sa realiste dhe e zbatueshme është strategjia në raport me nevojat pas reformës 2016, duke përfunduar dhe tërhequr vëmendjen për nevojën serioze që ka sot sistemi gjyqësor për tu vlerësuar si emergjencë kombëtare.

## Pasoja të reformës mbi efikasitetin e gjyqësorit

Reforma në Drejtësi e vitit 2016, prodhoi në praktikë një efekt të rëndë, krizën e funksionalitetit në gjykata. Prosesi i vettingut shkaktoi vakanca masive, të cilat nuk u shoqëruan me masa tranzitore për të ruajtur kapacitetet. Nuk u parashikuan dhe ende mungojnë masa të përkohshme dhe emergjente për të shtuar numrin e gjyqtarëve, edhe jashtë Shkollës së Magjistraturës. Rezultati është një sistem gjyqësor i tkurrur ndjeshëm, i paaftë të përballojë fluksin e çështjeve të reja, ndërkohë që stoku i dosjeve të mbartura rritet me ritme alarmante.

Shkaqe të tjera që e rëndojnë situatën, përfshijnë:

- Ngarkesa Disproporcionale - Çdo ankim/rekurs, pavarësisht vlerës juridike, mbërrin në gjykatat e apelit dhe atë të Lartë, duke i mbingarkuar në mënyrë artificiale ato. Kjo situatë vjen për shkak të një kulture të administratës shtetërore e cila ankimon në mënyrë autopilot çdo vendim gjyqësor, gjë që çon në rritje fiktive të punës, sidomos në Apelin Administrativ dhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Mungesa e Filtrave Ligjorë dhe Masave Ndëshkuese - Nuk aplikohen gjobat në rast të ankimeve dhe rekurseve haptazi të pabazuara, gjë që nuk dekurajon rastet flagrante. Gjithashtu, mungojnë në

legjislacion filtra për të penguar ankimin e vendimeve për disa kategori çështjesh, si ato të pensionit apo çështje të tjera që kalojnë në vendimmarrje të organeve kuazi-gjyqësore.

- Deficiti i Burimeve Mbështetëse - Mungesa e këshilltarëve ligjorë dhe stafit administrativ ul ndjeshëm kapacitetin për trajtim cilësor e të shpejtë të dosjeve.
- Infrastrukturë e Dobët dhe Mungesë Dixhitalizimi - Dosjet fizike voluminoze, mungesa e arkivave moderne dhe sistemet elektronike të menaxhimit të çështjeve kontribuojnë në krizë.

Këto faktorë të kombinuar bëjnë që stoku të jetë jo vetëm një fenomen i pashmangshëm, por edhe progresiv.

## Analizë kritike e Strategjisë së KLGJ 2024-2027

Strategjia Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura (2024-2027) bashkë me Udhërrëfyesin për rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor (2025-2027) prezantojnë ndërhyrje të nevojshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) në adresimin e pengesës më serioze për aksesin në drejtësi, zvarritjes së proceseve përtej çdo afati të arsyeshëm. Këto dokumente strategjike paraqiten si një hap vendimtar drejt përmirësimit të efikasitetit të gjykatave shqiptare.

Por ndërsa në letër, strategjia ofron masa

administrative, teknologjike dhe organizative, të cilat synojnë jo vetëm të ulin stokun e dosjeve, por edhe të ndërtojnë një qasje më moderne të menaxhimit gjyqësor, leximi i kujdesshëm i saj lë shijen e një teksti që më shumë kërkon të krijojë imazhin e reformës sesa të përballojë realisht problemin. Për një avokat që përditë përballet me gjykata të mbingarkuara dhe klientë që presin vite për një vendim, ky dokument nuk arrin të japë siguri se qytetari do të marrë drejtësi më shpejt, në dekadat që do të vijnë. Që në faqet e para vihen re projeksione numerike që nuk mbështeten mbi një metodologji të qartë, dhe ofrojnë mesatare agregate në vend që të ofrojnë një tablo realiste.

Strategjia thekson rëndësinë e "menaxhimit aktiv të çështjeve", "përdorimit të modeleve standarde për vendimet gjyqësore" dhe "zhvillimit të seancave gjyqësore në distancë", duke përfshirë dixhitalizimin e plotë të dosjeve, por nuk shoqëron shifrat me metodologji dhe bazë krahasimi, si pikënisje të matshme.

## **"Katastrofa e paralajmëruar" - Gjykatës Administrative të Apelit i duhen 14.6 vite për të mbyllur një çështje**

Në disa gjykata si Gjykata Administrative e Apelit, strategjia pranon se edhe pas vitit 2027 do të mbeten mijëra çështje pezull, pavarësisht rritjes së pretenduar të produktivitetit me 50%. Ky nuk është thjesht një problem, por një katastrofë e paralajmëruar, duke dëshmuar për një kolaps funksional. Strategjia tregon se nëse

shikohet koha mesatare për zgjidhjen e një çështjeje, në kushtet aktuale, "duhen mesatarisht 5 326 ditë (14.6 vjet)". Kjo nuk është thjesht një shifër statistikore, por një mohim i drejtpërdrejtë i aksesit në drejtësi për qytetarët dhe bizneset. Këtu, Strategjia bëhet provokuese.

A i duhet kërkuar një gjyqtari të prodhojë më shumë vendime, kur ngarkesa i kërkon të punojë për 15 vitet e ardhshme vetëm për të adresuar stokun ekzistues?

Përpjekja për të korrigjuar këtë me rritje të produktivitetit prej 50% nuk sjell rezultat të dukshëm. Vetëm me një rritje të produktivitetit prej 80% zhduken çështjet e prapambetura deri në vitin 2030, thuhet në strategji. Kjo do të kërkonte, rritje strukturore të numrit të gjyqtarëve nga viti 2024 – 2030, por edhe zbatimin e masave shtesë, kombinuar me ndryshime të menjëhershme infrastrukturore, ndryshime ligjore, rritje të produktivitetit të gjyqtarëve si dhe rritjen e stafit mbështetës jo-gjyqtar.

Projeksionet e prezantuara nëpërmjet shifrave në dukje, janë një realizëm i vonuar, por në thelb mbetet një pranim se strategjia nuk ofron dot zgjidhje. Ato shifra, të vendosura si në një tabelë kontabiliteti, nuk shpjegojnë mbi çfarë logjike janë llogaritur, kush i ka projektuar dhe pse duhet të besohet se këto masa do të jenë të mundshme. Aktualisht gjykatat nuk mund të arrijnë një produktivitet kaq të lartë në kushte kur mungesat e stafit, hapësirave dhe teknologjisë janë evidente. Në këtë kuptim, kemi më shumë një ushtrim optimizmi burokratik, sesa një plan operacional.

## Sfida Monumentale e Gjykatës së Apelit të Përgjithshëm: Loja me shifrat fsheh "Bishtin e Gjatë" të Backlog-ut

Zemra e problemit është pranimi i krizës së burimeve njerëzore si pasojë e vetëingut, ku shumë gjyqtarë u shkarkuan ose vendosën të japin dorëheqjen. Për të adresuar gropën që la vetingu, Strategjia thekson angazhimin maksimal për plotësimin e trupës gjyqësore, megjithatë zgjidhja që ofrohet mbetet në formulime të vagullta si rekrutime të reja apo rritje kapacitetesh. Përvoja e dekadës së fundit ka treguar se këto janë premtime të përsëritura, që nuk shoqërohen me plane kohore, buxhete të qarta apo mekanizma monitorimi.

Ndërsa zgjidhja e vetme që vihet re është transferimi i barrës te gjyqtarët në detyrë, duke u kërkuar këtyre të gjykojnë më shumë dosje në më pak kohë. Kjo mbetet një recetë e rrezikshme, sepse prodhon vendime të dobëta, të rrëzuara më pas në instanca më të larta, duke rritur paradoksisht edhe më shumë stokun. Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (GJAJP), ngarkesa e çështjeve në pritje në fund të vitit 2023 raportohet të jetë 37 662, por shifra tjetër tronditëse është se në këtë gjykatë aktualisht janë vetëm 26 gjyqtarë në detyrë, ndërsa organika e hartës së re parashikon 78 gjyqtarë.

Strategjia e pranon se "ndërtesa e saj aktuale nuk gëzon kushtet infrastrukturore për një rritje të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve". Ky është një pranim kritik i dështimit

ndërinstitucional. Si mund të planifikohen 78 gjyqtarë kur nuk ka salla apo zyra ku ata mund të punojnë? Ky dështim në planifikimin e infrastrukturës thekson se problemi i KLGJ - së nuk është vetëm plotësimi i trupës, por koordinimi bazik me pushtetin ekzekutiv për të siguruar mjetet fizike të punës, duke e lënë këtë krizë thelbësore të zgjidhet nëpërmjet gjetjes së "një numri adekuat" të ngritjeve në detyrë, çka nënkupton se rritja e produktivitetit, varet nga ndërhyrje urgjente dhe të kushtueshme.

Por edhe rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore me gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë në vetvete prezantohet me problemet e veta. E ndërsa synimi është të plotësohet numri i plotë i gjyqtarëve në vitin 2028 dhe jepen shifra konkrete të të diplomuarve (32 gjyqtarë në 2024, 45 në 2025, 20 në 2026), Strategjia nuk jep një përgjigje bindëse për dy çështje të rëndësishme:

- Analiza e fluksit të dobët - Dokumenti pranon por nuk analizon shkaqet rrënjësore të "interesit të ulët nga ana e profesionistëve të së drejtës" për karrierën e ndihmësve ligjorë, ndërsa e lë të paqartë nëse burimet e Shkollës së Magjistraturës janë të mjaftueshme për të përballuar nevojën reale.
- Alternativat e injektimit në sistem, qoftë përkohësisht të "përvojës" - Mungon një plan i guximshëm dhe i përkohshëm për të hapur sistemin ndaj prurjeve të kualifikuara nga profesionistë të avokatisë. Kjo mungesë e kësaj analize tregon një ngurrim për të prekur rrugë alternative, duke mbajtur një qasje konservatore përballë një krize emergjente.

aktualisht ky numër ka rënë nën 10 000 çështje në vit. Asnjë shpjegim nuk gjendet cilët janë faktorët që ndikojnë në këtë trend. Gjetja e shkakut ndihmon në gjetjen e diagnozës.

Më tej thuhet se ndërsa para vitit 2013 duheshin 270 ditë për të zgjidhur një çështje civile, në Gjykatën e Apelit, në vitin 2023 kohëzgjatja ka arritur 1 250 ditë, apo ndryshe një rritje pothuajse katërfish.

Këtu qartësia statistikore shkëmbehet me realitetin praktik. Kjo mesatare e thjeshtë prej 1 250 ditësh ose 3.4 vitesh, nuk pasqyron realitetin e hidhur të pritjes, me të cilin përballen palët në gjykatën e apelit. Çdo avokat e di që në këtë gjykatë sot shqyrtohen çështje të regjistruara në vitin 2017 dhe kjo ka qenë situata edhe në vitin 2023, kur janë marrë të dhënat e prezantuara në strategji. Kjo nënkupton një kohëzgjatje prej 6 vitesh në 2023 dhe prej 8 vitesh në 2025. Deklarimi i kohëzgjatjes prej 3.4 vitesh prodhon një pamje jo reale dhe i zbut ndjeshëm dimensionet e problemit.

Edhe nëse shifra 1 250 ditë del "statistikisht e saktë" sipas metodologjisë së KLGJ-së, interpretimi mbetet selektiv. Në mungesë të informacionit mbi metodologjinë që mungon në strategji, kjo mbetet një mesatare agregate që nuk prezanton realitetin. Çështjet e mbyllura shpejt (p.sh., çështje të hequra dorë ose të zgjidhura në dhomë këshillimi) ulin mesataren dhe krijojnë një pamje jo-përfaqësuese për shumicën dërrmuese të çështjeve që kërkojnë shqyrtim të plotë kolegjal.

Për të siguruar një tablo të besueshme dhe për ta kthyer strategjinë në një instrument serioz

planifikimi, KLGJ-ja duhet të kapërcejë "komoditetin" e mesatares dhe të raportojë metrika më të detajuara. Në mungesë të këtyre, publiku i specializuar mbetet skeptik ndaj vullnetit real për të adresuar problemin në thellësi. Një gjuhë "statistikisht e zbutur" në planifikim është një pararendës i dështimit në zbatim. Raportimi i medianes dhe percentilave (P75/P90), do të tregonte saktësisht se sa zgjasin 75% ose 90% e çështjeve, duke demonstruar qartë "bishtin e gjatë" të vonesave.

## Izolimi i hartimit të strategjisë nga ekspertiza e shoqërisë civile

Strategjia propozon një "paketë ndryshimesh ligjore", që në thelb synon të jetë një ndërhyrje efikase për uljen dhe parandalimin e stokut të çështjeve në gjykata. Kjo paketë përfshin disa masa të rëndësishme, të cilat, megjithëse të dobishme në parim, mbeten të pjesshme dhe në një pjesë të tyre pa një analizë të ndikimit.

Së pari, lehtësimi i gjykatës nga gjykimet e urdhrave të ekzekutimit parashikon ndryshime në Kodin e Procedurës Civile për heqjen e atyre urdhrave që nuk kërkojnë shqyrtim gjyqësor paraprak. Strategjia thekson se urdhrat e ekzekutimit përbëjnë 41.2% të ngarkesës së Gjykatës së Shkallës së Parë, çka e bën këtë ndërhyrje thelbësore për uljen e ngarkesës.

Së dyti, propozohet vendimmarrja me gjyqtar të vetëm në Apel për çështje "të thjeshta dhe të standardizuara" në fushën civile dhe administrative, që përbëjnë rreth 15% të stokut. Kjo masë, nëse zbatohet me kritere të qarta, do

të mund të çlironte kapacitete të vlefshme kolegjiale.

Së treti, Strategjia sugjeron kufizimin e ankimeve për çështje me vlerë të ulët, megjithatë nuk jepen të dhëna mbi përqindjen e këtyre rasteve apo ndikimin që mund të ketë masa në uljen reale të stokut, gjë që e bën vlerësimin e saj të vështirë.

Strategjia nuk ka eksploruar masa të tjera të këtij lloji, të cilat janë identifikuar më herët në raportet analitike të organizatave të shoqërisë civile.

Në raportin “28 Rekomandime për evadimin e dosjeve në Gjykatën e Lartë”, Qendra Res Publica<sup>4</sup> thekson se një pjesë e konsiderueshme e rekurseve (njësoj vlen analiza për apelimet) që shkojnë në gjykatë rrisin artificialisht stokun. (vlen për çështjet administrative). Kjo ndodh për shkak të praktikës së konsoliduar ku pala shtetërore, pavarësisht meritës së çështjes, ankimon çdo vendim gjyqësor kur është gjyqshëm. Në këtë raport sugjerohet që, për të shmangur këtë ngarkesë të panevojshme, Avokatura e Shtetit të aplikojë një mekanizëm filtrimi për apelimet dhe rekursat ekzistuese e të ardhshme, në mënyrë që të mos ankimohet çdo vendim në mënyrë automatike. Kjo kërkon ndërhyrje ligjore, por mund të realizohet edhe nëpërmjet politikave administrative të brendshme.

Në një tjetër raport<sup>5</sup>, Res Publica propozon që disa kategori çështjesh – si ato që lidhen me të drejtën për informim publik, ku ekzistojnë mekanizma quasi-gjyqësorë (si vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit), të

mund të gjykohen vetëm në një shkallë, duke eliminuar fazat e panevojshme të ankimit. Kjo do të ulte ndjeshëm numrin e çështjeve që shkojnë në gjykatën e apelit dhe atë të lartë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në një raport të tij<sup>6</sup> ka rekomanduar që KLGJ të analizojë hapësirat për plotësimin e vakancave në gjykatat e apelit dhe të shkallës së parë, duke ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe duke formuluar opinione ligjore që garantojnë një trupë gjyqësore profesionale, të pavarur dhe me integritet. Në po të njëjtin raport KSHH vlerëson nevojën e mbështetjes buxhetore për ngritjen e një sistemi elektronik të unifikuar për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, të bazuar në metodologjinë e CEPEJ, gjë e cila kërkon sërish amendime ligjore.

Përfshirja e këtyre rekomandimeve dhe të ngjashmeve të tjera të formuluar nga ekspertiza e pavarur do të kishte forcuar realizimin dhe ndikimin e Strategjisë. Më shqetësues mbetet fakti se Strategjia nuk parashikon mekanizma të hapur monitorimi dhe as përfshirjen e shoqërisë civile apo aktorëve të pavarur në procesin e vlerësimit dhe llogaridhënies.

Në gusht 2025, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi një vendim për hartimin e një rregulloreje që synon ngritjen e një Komisioni Ad Hoc për mbikëqyrjen, monitorimin dhe vlerësimin sistematik të objektivave të përcaktuara në Udhërrëfyesin për efikasitetin e pushtetit gjyqësor 2025–2027. Sipas parashikimit, ky Komision do të kryejë monitorime tremujore, të cilat mund të përfshijnë edhe monitorimin e masave të Strategjisë aktuale. Megjithatë,

mbetet për t'u parë nëse ky mekanizëm do të funksionojë në praktikë dhe nëse rezultatet e tij do të publikohen në mënyrë transparente. Pa monitorim të jashtëm dhe raportim të hapur, Strategjia rrezikon të mbetet një ushtrim formal, më shumë një detyrim procedural sesa një instrument real i reformës.

Në formën aktuale, dokumenti mbetet pjesërisht i izoluar, nga përvoja praktike dhe analiza e grupeve që kanë ndjekur nga afër dinamikën e stokut gjyqësor në këto vite, ndërsa hartimi i strategjive vazhdon të mbetet një proces i mbyllur institucionalisht, pa një mekanizëm të qëndrueshëm konsultimi me aktorët që kanë ndërtuar baza të vlefshme analitike dhe rekomanduese në terren.

## **Kostoja e heshtjes pas rihartëzimit - Një rritje e panjohur e krizës**

Bashkimi i gjykatave të apelit në një të vetme në Tiranë në shkurt të vitit 2023 ishte lëvizja më radikale pas reformës gjyqësore dhe, sipas Strategjisë, synonte ekuilibrimin e ngarkesës. Sidoqoftë, ky bashkim nuk ishte një lëvizje pa kosto. Ai shkaktoi një trazim organizativ dhe funksional, të cilin Strategjia e KLGJ-së nuk e ka adresuar. Ajo kufizohet vetëm në theksimin e faktit se "zbatimi i hartës së re gjyqësore përgjatë vitit 2023 synoi jo vetëm ekuilibrimin e ngarkesës nëpër gjykata" por edhe unifikimin e cilësisë së drejtësisë.

Edhe Udhërrëfyesi për Efikasitetin, i miratuar në korrik 2025, shënon se Harta e Re Gjyqësore ka qenë një faktor kyç, në

përmirësimin e treguesve dhe ka sjellë "konsolidimin e burimeve njerëzore". Përtej këtyre shënimeve të thata, analiza mungon.

Thjesht përmendja e hartës së re pa mjetet për ta përballuar krijon pamje jo reale dhe nuk shërben për uljen faktike të çështjeve. Mungesa e analizës së detajuar para dhe pas bashkimit të gjykatave është mangësi thelbësore e strategjisë. Pa një bazë fillimi të dhënash, plan tranzicioni, monitorim publik, centralizimi rrezikon të shtyjë dhe jo të zgjidhë problemin e backlog-ut. Integrimi i masave të mësipërme është kusht për ta kthyer reformën nga deklaram formal në menaxhim të verifikueshëm të stokut. Në këto kushte kemi të paadresuar dyshimet kryesore të avokatisë dhe aktorëve të tjerë praktikues të sistemit.

- A u bë më i shpejtë apo më i ngadaltë gjykimi në apel?

Në vend që të paraqitet një analizë krahasuese e performancës (si p.sh., kohëzgjatja mesatare e çështjeve, shkalla e anulimeve/kthimeve në rigjykim) për periudhat para dhe pas shkurtit 2023, Strategjia ofron përgjithësisht shifra të përgjithshme vjetore, nga ku indirekt mund të dalim në ndonjë përfundim. Për shembull, në Strategji thuhet se në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, vërehet një rënie e numrit të çështjeve të gjykuara, ku para vitit 2019 zgjidheshin mesatarisht 17 000 çështje në vit, ndërsa aktualisht (viti 2023) ky numër ka rënë nën 10 000 çështje në vit. Ky tregues, në vetvete, dëshmon për një efekt negativ të thellë në produktivitet, i cili nuk mund t'i atribuohet vetëm mungesës së gjyqtarëve.

- Bashkimi i trupave gjyqësore në një godinë të vetme në fillim të vitit 2023 kërkonte një

- strategji funksionale për të garantuar që ngarkesa të transferohej dhe përpunohej pa krijuar kolaps.

Strategjia nuk ofron asnjë plan se si menaxhohet konkretisht ky bashkim për të shmangur ngarkesën e menjëhershme dhe fluksin e çështjeve në Tiranë, por duke siguruar edhe infrastrukturën përkatëse.

- KLGJ-ja e justifikon hartën e re gjyqësore duke thënë se ka sjellë "shpërndarje më të drejtë të ngarkesës", por shifrat e saj tregojnë të kundërtën e dëshiruar.

Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, organika u rrit në 78 gjyqtarë, ndërsa në detyrë janë vetëm 26. Kjo shifër nuk tregon thjesht një mungesë, por një hendek monumental prej dy të tretash (66%) midis nevojës dhe realitetit. Për më tepër, Strategjia vetë pranon se kjo gjykatë ka 37 662 çështje në pritje (në vitin 2023). Ky volum i madh, i shtuar në një gjykatë qendrore me burime të pamjaftueshme dhe pa infrastrukturë të përshtatshme, tregon se bashkimi i apelit ka rritur gjeografikisht përqendrimin e krizës, në vend që ta shpërndajë atë.

Në mungesë të një "monitorimi apo strategjie se çfarë do të sillte kjo dhe si do të përballohet", siç duket, KLGJ-ja, duke bashkuar gjykatat, ndërmoi një rrezik të madh, efektet e të cilës po evidentohen. Ne shohim se shifrat e prapambetjes janë rritur ose mbetur në nivele kritike pavarësisht "reformës". Kjo sugjeron se Harta e Re Gjyqësore, në gjykatën e apelit, mund të ketë qenë një strategji e pamatur dhe e ekzekutuar në mënyrë të papërshtatshme, e cila ka thelluar krizën, në vend që ta zgjidhë atë. Por më e keqja është që për këto efekte nuk flitet.

## Përmirësimi i Infrastrukturës mbetet një ide e Papërcaktuar

Strategjia pranon se ndërtesat aktuale nuk gëzojnë kushtet infrastrukturore për një rritje të konsiderueshme të numrit të gjyqtarëve. Sidomos Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm e Apelit, ka mungesa sallas, pasi harta e re gjyqësore nuk mori parasysh kushtet aktuale të kësaj ndërtese, përpara realizimit dhe ndërtesa aktuale nuk kishte kapacitetin për të pritur bashkimin e të gjithë gjykatave të Apelit.

Përballë kësaj situatë, Strategjia ofron vetëm shpresë për përmirësim infrastrukture pa detaje konkrete të financimit apo afate kohore realiste për ndërtim. Kjo është një lëshim i madh, duke qenë se infrastruktura është një parakusht i drejtpërdrejtë për të akomoduar gjyqtarët e rinj.

## Fati i strategjisë në duart e të tjerëve

Strategjia paraqet një dualitet thelbësor; Ambicie të lartë në planifikim, por varësi kritike nga faktorë jashtë juridiksionit të KLGJ-së. Dokumenti lë të hapur çështjen thelbësore.

A është KLGJ-ja mjaftueshëm e fuqishme, qoftë politikisht ashtu edhe financiarisht, për të kaluar këtë krizë të thellë strukturore?

Pra përmbajtja nuk është problem i vetëm i strategjisë, por edhe realizimi politik i saj. Strategjia, në Konkluzione, e pranon me një

gjuhë të qartë dhe pothuajse dëshpëruese se pa mbështetjen institucionale, ky dokument "do të mbetet fiktiv dhe pa vlerë". Vonesat në miratimin e paketës ligjore do të shkaktojnë "vonesa në përmbushjen e indikatorëve të suksesit". Efektiviteti i gjithë planit varet nga mbështetja buxhetore. Strategjia pranon se "zbatimi i disa masave sjell ndikim në buxhetin e shtetit" dhe KLGJ-ja ka nevojë për "mbështetjen institucionale me prioritet të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave". Kjo gjuhë, e cila shpreh varësinë thelbësore, e zhvesh KLGJ-në nga fuqia e saj vendimmarrëse, duke e kthyer atë në një kërkuese buxhetore.

Kështu ne shohim një plan të detajuar, por pa një "kontratë" politike të garantuar për financimin e plotë të tij. Derisa kjo mbështetje institucionale të materializohet, Strategjia mbetet një aspiratë e dobët, e denjë për t'u shkruar në një seminar, por jo e mjaftueshme për të zgjidhur vonesat 14.6-vjeçare të sistemit gjyqësor shqiptar.

Strategjia e KLGJ-së 2024–2027 artikulon objektiva të dukshme për uljen e stokut dhe modernizimin e menaxhimit gjyqësor, por mbetet e brishtë në themel. Mungojnë vlerësimi kumulativ i strategjive pararendëse, metodologjia e matjes dhe një lidhje organike midis qëllimeve dhe mjeteve. Raportet e progresit shënojnë arritje formale si “norma e likuidimit” apo dixhitalizimi i arkivave, por pa indikatorë numerikë të verifikueshëm për ulje reale të çështjeve të mbartura sipas viteve të regjistrimit, Pa këto dhe pa një arkitekturë monitorimi që e bën llogaridhënien të matshme, strategjia rrezikon të jetë më shumë një plan komunikimi sesa një udhërrëfyes operacional.

Përdorimi i statistikave në strategji ndihmon në ilustrimin e problematikave, por nuk arrin t'i shpjegojë ato në thellësi. Referencat ndaj kohëzgjatjes mesatare të shqyrtimit të çështjeve ofrojnë një tablo të përgjithshme, por nuk pasqyrojnë realitetin e çështjeve të stokuara për periudha shumëvjeçare. Mungesa e treguesve përfaqësues, si medianat, percentilat (P75/P90), moshat e stokut sipas vitit të regjistrimit apo treguesit të harmonizuar të CEPEJ-it (si Disposition Time dhe Clearance Rate), e kufizon saktësinë e analizës.

Kjo qasje e përgjithësuar krijon rrezikun që politikat të projektohen mbi një mesatare abstrakte, ndërkohë që barra reale e sistemit përqendrohet te një numër më i vogël, por shumë më i vështirë i çështjeve të vjetra. Si pasojë, perceptimi publik për efikasitetin e drejtësisë mbetet i deformuar, pasi treguesit e agreguar nuk përkthehen në përvojën konkrete të palëve në proces.

Në mungesë të një klasifikimi paraprak të çështjeve (klasifikimi i menjëhershëm i urgjencës dhe kompleksitetit), të korridoreve të dedikuara për çështjet e vjetra dhe të rishpërndarjes dinamike të stafit, ky centralizim ka prodhuar një "Gyp Hinke" (Funnel Effect). Si pasojë, stoku i çështjeve (backlog-u) jo vetëm nuk zgjidhet, por thjesht migron drejt një pike të vetme mbingarkese, duke i dhënë avokatisë dhe publikut një shërbim dukshëm më të ngadaltë.

I mungon Strategjisë një nga pikat kyçe të analizës që lidhet me ndryshimin e hartës gjyqësore në shkurt 2023, e cila bashkoi të gjitha gjykatat e apelit në një institucion të vetëm në Tiranë. Kjo u ndërmor pa asnjë analizë ndikimi para dhe pas dhe pa një plan tranzicioni funksional, gjë për të cilën strategjia përsëri hesht. Si rezultat, efekti praktik është thellësisht destabilizues. Që në fillim u shkaktua përqendrimi i krizës së backlog-ut në kryeqytet. Ky bashkim prodhoi një organikë të rritur vetëm në letër, e cila megjithatë mbeti në një hendek monumental të burimeve njerëzore (një numër real gjyqtarësh dukshëm nën nevojë) dhe pa infrastrukturë adekuate.

Kriza e burimeve njerëzore dhe e infrastrukturës mbetet boshti i pashpjeguar mjaftueshëm për reduktimin e numrit të çështjeve. Në këtë sfond, pritshmëritë për rritje produktiviteti +50% deri +80% janë jo realiste.

Një tjetër boshllëk thelbësor është izolimi i strategjisë nga ekspertiza e jashtme dhe roli i shoqërisë civile. Rekomandime të mirë-argumentuara, si ato të Res Publica (filtrim real

të ankimeve, filtra ligjorë për vendime që nuk ankimohen) dhe KSHH (zgjidhje fleksibël për vakancat, sistem elektronik i unifikuar me statistika të avancuara), mbeten jashtë trajtimit dhe kornizës zyrtare. Pa një partneritet të institucionalizuar strategjia humbet korrigjueshmërinë që sjell kritika e bazuar në të dhëna.

Më tej, dokumenti pranon varësinë politike dhe buxhetore. Pa mbështetje të Kuvendit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, shumë masa mbeten aspirative. Kjo kërkon një “kontratë politike” të qartë, me afate, financim shumëvjeçar, përgjegjësi të shpërndara dhe raportim publik tremujor. Vetëm kështu objektivat e përgjithshëm mund të konvertohen në detyra të verifikueshme dhe të detyrueshme.

Në thelb, strategjitë e njëpasnjëshme kanë krijuar një spirale ku diagnostikimi përsëritet, por trajtimi shtyhet. Prodhohen dokumente të reja pa reflektuar pse të mëparshmet dështuan. Ky cikël shpjegon hendekun në rritje midis premtimeve dhe realitetit, si edhe rënien e besimit publik. Dalja nga kjo spirale nuk kërkon më shumë retorikë, por një metodologji të rreptë matjeje, klasifikim të çështjeve dhe pilotim, infrastrukturë të përshtatshme, burime reale njerëzore dhe partneritet me shoqërinë civile. Vetëm kështu “ulja e numrit të çështjeve” del nga gjuha e strategjive dhe bëhet përvojë e matshme e qytetarëve, duke e tërhequr të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga statistika drejt realitetit.

[1] Arb shpk dhe të tjerë k. Shqipërisë, maj 2025, [https://hudoc.echr.coe.int/#%22itemid%22:\[%22001-243249%22\]](https://hudoc.echr.coe.int/#%22itemid%22:[%22001-243249%22])

[2] "Strategjia për uljen e numrit të çështjeve 2024-2027", KLGJ maj 2025

[3] "Udhërrëfytyesi për efikasitetin e pushtetit gjyqësor 2025–2027"

[4] "28 Rekomandime për evadimin e dosjeve në Gjykatën e Lartë", T Aleksandridis, I.Dule, D. Matlija, shtator 2021, <https://www.respublica.org.al/ep-content/uploads/2021/12/28-Rekomandime-per-evadimin-e-dosjeve-nga-Gjykata-e-Larte.pdf>

[5] "E drejta e Informimit 2023", D. Matlija, I.Dule, B. Qershori, mars 2024, [https://www.respublica.org.al/ep-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023\\_web.pdf](https://www.respublica.org.al/ep-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023_web.pdf)

[6] "Raport mbi veprimtarinë e Këshillit të lartë gjyqësor dhe këshillit të lartë të prokurorisë si dhe administrimit të dhjetë gjykatave ngarkesën më të lartë në vend", KSHH gusht 2022, [pdf https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/08/raport-mbi-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor-dhe-keshillit-te-larte-te-prokurorise-si-dhe-administrimit-te-dhete-gjykatave-me-ngarkesen-me-te-larte-ne-vend.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/08/raport-mbi-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor-dhe-keshillit-te-larte-te-prokurorise-si-dhe-administrimit-te-dhete-gjykatave-me-ngarkesen-me-te-larte-ne-vend.pdf)